



Data: 18 korrik 2018

Buletin Informativ

Nr.3, 2018

Takim mbi masat e marra nga strukturat e policisë të DVP Kukës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.



Më datë 21.06.2018, në ambientet e DVP Kukës, u zhvillua një takim pune mbi masat e marra nga strukturat e policisë të DVP Kukës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.

Në këtë takim morën pjesë ZV/Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit Drejtuese e Lartë Aida Hajnaj, Drejtori i Departamentit të Sigurisë Publike Drejtues i Lartë Gjovalin Loka, Drejtori i Drejtorisë së Krimeve Kundër Personit dhe Pronës në Departamentin për Krimet Drejtues i Parë Niko Brahimaj, Drejtori Vendor i Policisë Kukës Drejtues Zef Laska, shefat Komisariateve të policisë Kukës, Has dhe Tropojë, si dhe efektivë të DVP Kukës.

Drejtori i Drejtorisë Vendorë të Policisë Kukës prezantoi punën e bërë dhe masat e marra nga strukturat e DVP Kukës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të

kultivimit të bimëve narkotike, duke përmendur si masat sensibilizuese, ashtu edhe masat operacionale.

Masat kryesore operacionale janë fokusuar në:

- Sigurimin e informacionit për autorët e mundshëm që do të kryejnë kultivimi të bimëve narkotike.
- Sigurimin e informacionit për vendet dhe zonat që mund të shfrytëzojnë autorët për kultivimin e kanabisit.
- Kontrollin e ambienteve të mbyllura, të hapura dhe zonave të klasifikuara me risk të lartë gjatë vitit 2017.
- Bashkëpunimin me institucionet e tjera ligj zbatuese për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.

Nga Drejtori i DVP Kukës u theksua fakti se deri tani në Qarkun Kukës nuk është evidentuar asnjë rast i kultivimit të bimëve narkotike. Shefat e komisariateve të policisë Kukës, Has dhe Tropojë prezantuan rezultatet e punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike.

Krijohet Këshilli Vendor i Sigurisë Publike në Bashkinë Bajram Curri dhe në Bashkinë Has.

Në kuadër të forcimit të bashkëpunimit në nivel vendor për adresimin e çështjeve të sigurisë dhe forcimin e policimit në komunitet, me asistencën e Programit SCPA u zhvillua me date 27 dhe 28 qershor 2018, mbledhja e parë e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në bashkinë Bajram Curri dhe në bashkinë Has. Krijimi i këtyre Këshillave bazohet në ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe atij për policinë e shtetit dhe në praktikat më të mira evropiane. Të dy bashkitë e mirëpritën këtë iniciativë dhe shprehën angazhimin e tyre për rritjen e bashkëpunimit në parandalim si dhe trajnimin e problemeve të sigurisë. Anëtarët dhe pjesëmarrësit janë përfaqësues të institucioneve vendore që kanë lidhje të



Botuar nga: Zyra për Komunikimin me Median dhe Publikun në D.V.P. Kukës:

Tel: +355 69 4115009

@kukes@gmail.com



Drejtorja Vendore Policisë kukes

drejtpërdrejte me çështjet e sigurisë por edhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile, komunitetet fetare, komuniteti i biznesit, shkollat etj. Programi do mbështesë në vazhdimësi këto këshilla për të forcuar më tej kapacitetet e tij dhe si dhe ndikimin në sigurinë e bashkive përkatëse.



lokale.

Drejtori i DVP Kukës, Drejtues Zef Laska bëri një prezantim me të pranishmit dhe falënderoi Kryetarin e Bashkisë për takimin e përbashkët. Zoti Laska u shpreh se Bashkia e Hasit është në parametrat më të mira për kriminalitet të ulët, nuk ka trafiqe, krime të rënda, kjo situatë vjen dhe për shkak të qytetarisë së Hasit dhe punës së përbashkët.

Komisariati i Policisë së Hasit është institucioni kryesor, por i vetëm nuk mund të bëjë asgjë nëse nuk ka bashkëpunim. Po të marrim rastet e konflikteve mes nxënësve, nëse do të punojmë së bashku polici, mësues, stafi i prindërve produkti do të jetë shumë pozitiv. Të parandalosh është më lehtë sesa të kurosh. Në përfundim, të pranishmit falënderuan programin Suedez, për mbështetjen e vazhdueshme që i jep DVP-së Kukës dhe aktorëve

Ceremonia e dorëzimit të mjeteve për zjarrfikësen e Kukësit, dhuruar nga Bashkia Steinkirchen e Landit të Bavarisë në Gjermani.



Më datë 26.06.2018, në shëtitoren e Qytetit u zhvillua ceremonia e dorëzimit të mjeteve për shërbimin zjarrfikës të bashkisë së Kukësit, dhuruar nga Bashkia Steinkirchen e Landit të Bavarisë në Gjermani, ku morën pjesë Drejtori i DVP Kukës Drejtues Zef Laska, Kryetari i Bashkisë Kukës, Z. Bashkim Shehu, eksperti i programit Suedez, SCPA, Z. Alexius Schubert.

Bashkia Steinkirchen e Landit të Bavarisë në Gjermani, dhuroi një set pajisjesh speciale për shërbimin zjarrfikës edhe për Bashkinë e Hasit dhe Tropojës në kuadër të bashkëpunimit Polici-Pushtet Vendor, për të adresuar çështjet e sigurisë ndaj



zjarreve në qark. Koordinimi është bërë nga eksperti i programit Suedez, Forcimi i Policimit në Komunitet, Z. Alexius Schubert, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Bashkinë Kukës.

Gjithashtu, shërbimet e policisë rrugore së bashku me shërbimin zjarrfikës dhe shërbimin e ambulancës, demonstuan përdorimin e këtyre pajisjeve speciale në rastet e aksidenteve automobilistike, për dhënien e ndihmës sa më të shpejtë të personave të përfshirë në aksidente.

Ceremonia përkujtimore e 20-vjetorit të rënies së efektivit të policisë së shtetit Rustem Goçi.

Më datë 29.06.2018, në kuadër të 20 vjetorit të rënies së efektivit të Policisë së Shtetit Rustem Goçi, Drejtoria Vendore e Policisë Kukës zhvilloi një ceremoni përkujtimore në varrin e të ndjerit, ku morën pjesë Drejtori Vendore i Policisë Drejtues Zef Laska, shefi Komisarariatit të Policisë Has dhe Kukës, familjarë të të ndjerit dhe efektivë të DVP Kukës. Drejtori Vendor i Policisë vendosi kurorë me lule pranë varrit të të ndjerit në emër të të gjithë efektivëve të policisë Kukës, për të nderuar punonjësën e policisë të rënë në krye e për shkak të detyrës. Në përfundim të ceremonisë u zhvillua një vizitë pranë familjes së të ndjerit.



Zhvillohet analiza e 6 mujorit të parë 2018, e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës.

Më datë 09.07.2018, në ambientet e DVP Kukës, u zhvillua analiza e 6 mujorit të parë 2018, e Drejtorisë Vendore të Policisë Kukës. Në analizë morën pjesë Drejtori, Drejtues Zef Laska, shefat Komisariateve të policisë Kukës, Has dhe Tropojë, si dhe efektivë të DVP Kukës.

Gjatë analizës prezantuan rezultatet e punës së arritur gjatë 6 mujorit të parë 2018, nga shefat e Komisariateve dhe shefat e Sektorëve në DVP Kukës, si dhe prioritetet e 6 mujorit të dytë.

Gjatë Vlerësimit Strategjik të 6 mujorit të parë 2018 Drejtoria vendore e Policisë Kukës ka realizuar këto objektiva :

- Reduktimi i veprave penale të rënda të krimeve kundër personit.
- Rritja e forcës zbuluese të veprave penale kundër pronës.
- Reduktimin e kultivimit të bimëve narkotike.
- Ulje e numrit të aksidenteve rrugore.
- Rritje të evidentimit të veprave penale që lidhen me asetet kriminale.
- Rritje të zbulueshmërisë së veprave penale të evidentuara në nivel drejtorie krahasuar me vitin 2017, ku për 6 mujorin e parë të vitit 2018 krahasuar me 6-mujorin e parë 2017, janë evidentuar 68 vepra penale me pak dhe është rritur zbulueshmëria me +1.6 %.

